



Die Senatorin für Kinder und Bildung · Rembertiring 8-12 · 28195 Bremen

Për
të gjithë prindërit dhe kujdestarët ligjor

Auskunft erteilt
Helena Justa

Zimmer 411

Tel. 0421 361-12604
Fax 0421 496-12604

E-Mail:
helena.justa@
kinder.bremen.de

Mein Zeichen
(bitte bei Antwort angeben)
30-1

Bremen, 16.11.2021

Shumë të nderuar zonja dhe zotërinj,
të dashur prindër ose kujdestar ligjor,

që nga qershori i vitit 2021, kopshtet janë në të ashtuquajturin niveli bazë i planit të reagimit „Kujdesi ditor i fëmijëve në kushtet e pandemisë“. Kjo do të thotë që ju dhe fëmijët tuaj prekeni vetëm nga pak kufizime në qendrat e kujdesit ditor.

Në të njëjtën kohë, numri i infektimive tek personat e pa vaksinuar po rritet shumë ndjeshëm. Edhe pse për momentin ka vetëm pak infektime të fëmijët në kopshtet e bremenit, **testimi i vazhdueshëm i fëmijëve dhe punonjësve është shumë i rëndësishëm**. Nëpërmjet një rrjeti të ngushtë testimesh bëhet i mundur identifikimi i shpejtë i infektimeve të mundshme dhe parandalimi i përhapjes akoma më të madhe nëpër kopshte.

Për çdo fëmijë dhe çdo punonjës, senatorja për fëmijët ofron në dispozicion dy teste të shpejta çdo javë. Fëmijët nuk duhet të vijnë në kopsht pa u testuar. **Ju lutem testoni fëmijën tuaj dy herë në javë dhe mos e sillni fëmijën tuaj në kopsht nëse rezultati i testit është pozitiv.**

Jam e vetëdijshme se testimi – veçanërisht me fëmijët e vegjël – mund të jetë pak i mundimshëm. Por është shumë e rëndësishme që të gjithë fëmijët të kenë mundësi të vijnë në kopsht në mënyrë të sigurt dhe të besueshme.



Eingang:
An der Weide 50

Dienstgebäude:
An der Weide 50

Bus / Straßenbahn:
Haltestelle
28195 Bremen

Sprechzeiten:
montags bis freitags
Hauptbahnhof
von 9:00 - 14:00 Uhr

Në disa kopshte do të kryhen herë pas here „testet lëpirëse“ për grupe të tëra kopshtesh nga një personel mjekësor i trajnuar ose nga specialistë edukativë. Ju kërkoj që edhe këtu të pranoni pjesmarrjen e fëmijës suaj në këtë testim vullnetar.

Gjithë të mirat
Përgjegjës

Thomas Jablonski
-Përgjegjës i departamentit-